

Hagë, 2 shkurt 2023

PËRMBLEDHJE E AKTGJYKIMIT TË APELIT

Çështja gjyqësore nr. KSC-CA-2022-01

Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Në vijim do të gjeni përmbledhjen e Aktgjykimit të Apelit të shpallur nga Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit, i cili u lexua nga Kryegjykatësja.

Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit është mbledhur sot për të shqiptuar Aktgjykimin e Apelit në çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt*. Ky Aktgjykim shqiptohet publikisht, në emër të popullit të Kosovës, dhe në prani të të akuzuarve.

Kjo përmbledhje nuk është pjesë e Aktgjykimit të Apelit, dhe as nuk është autoritative. Aktgjykimi me shkrim është i vetmi dokument autoritativ i konstatimeve të Panelit. Aktgjykimi i Apelit do të vihet në dispozicion në formë elektronike pas kësaj seance dhe zotit Gucati dhe zotit Haradinaj do t'u jepen kopje të legalizuara të tij në gjuhën angleze.

Dhomat e Specializuara u krijuan në lidhje me akuzime të rënda për trajtim çnjerëzor, vrasje të personave dhe krime të tjera të rënda të kryera gjatë dhe pas konfliktit të armatosur në Kosovë. Para themelimit të Dhomave të Specializuara, pengesat e hasura nga gjykatat dhe tribunalët e tjerë në zbulimin e së vërtetës për këto ngjarje përbënin një shqetësim të vazhdueshëm. Këto përfshinin ngurrimin ose frikën e dëshmitarëve për të dëshmuar dhe mungesën e besimit të tyre tek masat mbrojtëse.

Pikërisht në këtë kontekst u krijuan Dhomat e Specializuara, me qëllim që të garantoheshin procese penale të sigurta, të pavarura, të paanshme, të drejta dhe efikase në lidhje me këto pretendime për krime të rënda.

Lloji i krimeve që përfshihen në juridiksionin e Dhomave të Specializuara dhe konteksti në të cilin u kryen ato, bëjnë të nevojshme mbështetjen në dëshmitë gojore. Është me rëndësi themelore për përmbushjen e misionit të Dhomave të Specializuara që individët të cilët vijnë për të dhënë dëshmi, shpesh për përvoja traumatike ose të vështira, ta bëjnë këtë pa pasur frikë. Mbrojtja e dëshmitarëve nga frikësimi dhe dëmtimi është në themel të çdo sistemi të drejtësisë penale, përfshirë edhe në Dhomat e Specializuara. Rrjedhimisht, kjo çështje gjyqësore ka të bëjë me administrimin e duhur të drejtësisë, integritetin dhe sigurinë e procesit dhe sigurinë e dëshmitarëve.

Ky Aktgjykim trajton apelet kundër konstatimeve të Trupit Gjyqësor në lidhje me përgjegjësinë e z. Gucati (*kryetar i Organizatës së Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës - "OVL-UÇK"*) dhe të z. Haradinaj (*nënkryetar i së njëjtës organizatë*) në një varg ngjarjesh që u zhvilluan gjatë një periudhe trejavore, nga 7 shtatori 2020 deri më 25 shtator 2020.

Më 18 maj 2022, Trupi Gjyqësor shqiptoi Aktgjykimin, me të cilin e shpalli fajtor secilin prej të akuzuarve për vepra penale kundër rendit publik dhe vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike. Të akuzuarit u shpallën fajtorë për pesë pika të Aktakuzës (Pikat 1, 2, 3, 5, 6) dhe të pafajshëm për një pikë (Pika 4) të Aktakuzës. Trupi Gjyqësor e dënoi secilin të akuzuar me një dënim të njësuar prej katër vjet e gjysmë burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim, dhe me një gjobë prej 100 eurosh.

Trupi Gjyqësor konstatoi se, gjatë periudhës së Aktakuzës, të akuzuarit morën, nga burime të panjohura, tri grupe dokumentesh që përmbanin informacion konfidencial dhe jopublik që lidhej me punën dhe hetimet e Task Forcës Hetimore Speciale ("TFHS") dhe të Zyrës së Prokurorit të Specializuar ("ZPS").

Ky material u dorëzua në zyrat e OVL-UÇK-së më 7 shtator 2020, 16 shtator 2020 dhe 22 shtator 2020.

Pas çdo dorëzimi, të akuzuarit thirrën dhe organizuan konferencë për shtyp, ku diskutuan dhe u vunë në dispozicion gazetarëve secilin prej grupeve të dokumenteve.

Gjatë së njëjtës periudhë, të akuzuarit, individualisht ose së bashku, dhanë një numër intervistash në media në lidhje me këtë material. Ata gjithashtu bënë komente për materialin dhe ripublikuan artikuj në mediat sociale. Çka mbetën nga grupet e dokumenteve, iu dorëzuan në vijim ZPS-së dhe u identifikuan si Paketat 1, 2, 3 dhe 4, ose "Paketat".

Të dy, z. Gucati dhe z. Haradinaj paraqitën apele me të cilët kundërshtuan vendimet e fajësisë për Pikat 1, 2, 3, 5 dhe 6 të Aktakuzës, si dhe kundërshtuan një numër konstatimesh të Trupit Gjykes lidhur me to. Gjithashtu, që të dy kundërshtuan edhe dënimin e dhënë. Apeli i z. Gucati përmbante 20 arsye për apel (me një numër nënpikash), dhe apeli i z. Haradinaj përmbante 24 arsye (me një numër nënpikash).

Konstatimet e Panelit të Apelit për kundërshtimet lidhur me aspekte të gjykimit të drejtë dhe të provave

Në pjesën hyrëse, ku trajtohen aspekte të gjykimit të drejtë dhe të provave, Paneli trajton gabimet e pretenduara nga z. Gucati dhe z. Haradinaj në lidhje me vendimet e Trupit Gjykes për të mos nxjerrë, ose për të redaktuar, një pjesë të materialeve që përmbanin Paketat. Paneli konstaton se dokumentet që përmbanin Paketat nuk janë relevante për përmbajtjen e tyre, por për natyrën e tyre konfidenciale.

Duke mbajtur parasysh se dokumentet që përmbanin Paketat ishin pjesë e hetimeve në kryerje e sipër të ZPS-së, Paneli konstaton se ishte e arsyeshme të urdhërohej që një hetues i ZPS-së të konfirmonte statusin konfidencial të dokumenteve si masë kompensuese për mosnxjerrjen e pjesëve të Paketave.

Paneli më tej vëren se Mbrojtja pati mundësinë t'i bënte pyetje hetueses së ZPS-së (dëshmitarja W04841) dhe se, krahas mbështetjes në këtë dëshmi, Trupi Gjykes vërtetoi autenticitetin dhe natyrën konfidenciale të Paketave duke u mbështetur në një

numër burimesh të tjera. Paneli i Apelit konstaton se të akuzuarit nuk kanë arritur të provojnë gabim në konstatimet e Trupit Gjykues.

Sa u takon vendimeve të Trupit Gjykues, në seanca *ex parte* pa praninë e Mbrojtjes, për materiale që u pretendua se kishin lidhje me argumentin e shtytjes për kryerje të veprës penale, Paneli gjykon se procedura e ndjekur nga Trupi Gjykues gjatë vlerësimit të kërkesës së ZPS-së sipas rregullës 108 të Rregullores i përmbush standardet e gjykimit të drejtë. Paneli, rrjedhimisht, rrëzon kundërshtimet e z. Haradinaj.

Paneli u kthehet argumenteve të z. Haradinaj se Trupi Gjykues gaboi që refuzoi të pranonte parashtrime pas mbylljes së gjykimit në lidhje me pretendimet e ngritura nga z. Dik Marti. Paneli i Apelit konstaton se z. Haradinaj nuk ka arritur të provojë gabim në konstatimin e Trupit Gjykues për mungesën e lidhjes ndërmjet këtij materiali dhe çështjes gjyqësore aktuale.

Kundërshtime të tjera në lidhje me aspekte të gjykimit të drejtë dhe të provave, trajtohen në Aktgjykimin e Apelit. Paneli tani do të trajtojë apelimin e Pikave 5, 6, 3, 1 dhe 2 të Aktakuzës.

Palët paraqitën argumente të hollësishme në lidhje me gabimet e pretenduara të Trupit Gjykues sa u takon elementeve materiale dhe mendore të veprave penale, dhe Paneli do të përmbledhë konstatimet kryesore.

Konstatimet e Panelit të Apelit për kundërshtimet lidhur me Pikën 5 të Aktakuzës

Pika 5 e Aktakuzës ka të bëjë me veprën penale të shkeljes së fshehtësisë së procedurës nëpërmjet zbulimit të paautorizuar të informacionit të fshehtë të nxjerrë në procedura zyrtare, e ndëshkueshme sipas nenit 392(1) të Kodit Penal të Kosovës. Të akuzuarit kundërshtuan konstatimet e Trupit Gjykues në lidhje me veprimin e fajshëm të kësaj vepre penale.

Paneli do të fillojë me kundërshtimet e të akuzuarve në lidhje me konstatimet se informacioni i mbrojtur u zbulua në mënyrë “të paautorizuar”. Z. Gucati parashtroi se nxjerrja e informacionit konfidencial në interesin publik, ose prej një sinjalizuesi, lejohet me ligj. Paneli, megjithatë, konstaton se këto argumente mbrojtëse mund ta përjashtojnë përgjegjësinë penale, por nuk do të ndikonin në veprimin e fajshëm të veprës penale sipas nenit 392(1) të Kodit Penal të Kosovës. Këto argumente, rrjedhimisht, nuk janë relevante për vlerësimin e kundërshtimeve ndaj veprimit të fajshëm të kësaj vepre penale.

Z. Gucati parashtroi se kryes i veprës penale mund të jetë vetëm “marrësi i parë i informacionit”, që nënkupton ZPS-në ose homologët e saj. Paneli e rrëzon interpretimin e z. Gucati dhe pajtohet me konstatimin e Trupit Gjykses se neni 392(1) i Kodit Penal të Kosovës nuk kërkon specifikisht që informacioni duhet t’i jetë nxjerrë drejtpërsëdrejti kryesit të veprës penale.

Për sa i përket llojit të informacionit të mbrojtur, Paneli rikujton se neni 392(1) i Kodit Penal të Kosovës penalizon dy alternativa: i) zbulimin e paautorizuar të informacionit i cili, sipas ligjit, nuk duhet të zbulohet, dhe ii) zbulimin e paautorizuar të informacionit që është shpallur si i fshehtë nga një autoritet kompetent.

Paneli ka bërë vlerësimin e argumenteve të të akuzuarve në lidhje me alternativën e dytë. Sa i takon interpretimit të termit “fshehtësi”, Paneli konstaton se z. Gucati nuk ka arritur të provojë se Trupi Gjykses gaboi që konstatoi se informacioni i trajtuar si konfidencial nga ZPS-ja duhej të konsiderohej si i fshehtë brenda kuptimit të nenit 392 (1) të Kodit Penal të Kosovës. Gjithashtu, në kundërshtim me pretendimin e z. Gucati, korniza ligjore e Dhomave të Specializuara nuk përmban asnjë detyrim për ZPS-në që të vërtetojë se informacioni në fjalë ishte klasifikuar si i fshehtë në mënyrë të ligjshme dhe të drejtë.

Pasi hodhi poshtë kundërshtimet ndaj njërës prej dy alternativave sipas nenit 392(1) të Kodit Penal të Kosovës, Paneli, në Aktgjykimin e Apelit nuk i trajtoi kundërshtimet në

lidhje me përmbushjen e kushteve për alternativën tjetër, konkretisht, në lidhje me atë nëse informacioni i mbrojtur i plotëson kriteret si informacion “që nuk duhet të zbulohet sipas ligjit”.

Në përfundim, për këtë pikë, Paneli i Apelit rrëzon kundërshtimet e Mbrojtjes ndaj konstatimeve të Trupit Gjykses për Pikën 5 të Aktakuzës.

Konstatimet e Panelit të Apelit për kundërshtimet lidhur me Pikën 6 të Aktakuzës

Pika 6 e Aktakuzës ka të bëjë me veprën penale të zbulimit të paautorizuar të identiteteve dhe të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur, e ndëshkueshme sipas nenit 392 (2) të Kodit Penal të Kosovës. Të akuzuarit kundërshtuan konstatimet e Trupit Gjykses në lidhje me veprimin e fajshëm të kësaj vepre penale.

Paneli do të fillojë me kundërshtimet e të akuzuarve ndaj konstatimeve të Trupit Gjykses në lidhje me termin “person” në kontekstin e formulimit “person [i mbrojtur në procedura penale]”.

Paneli konstaton se Mbrojtja nuk ka arritur të provojë gabim në konstatimin e Trupit Gjykses se, në kontekstin e Pikës 6 të Aktakuzës, termi “person” përfshin dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm sikurse u përkufizuan nga hetuesja e ZPS-së (dëshmitarja W04841).

Paneli do të trajtojë tani kundërshtimet e të akuzuarve ndaj konstatimeve të Trupit Gjykses për pjesën e dytë të formulimit, “i mbrojtur në procedura penale”. Z. Gucati argumentoi se mbrojtja duhet të “miratohet”, dhe jo të nënkuptohet. Të dy të akuzuarit argumentuan më tej se Trupi Gjykses gjykoi gabim se të gjithë personat e përmendur me emër në dokumentet e TFHS-së dhe të ZPS-së ishin të mbrojtur *ipso facto*.

Paneli konstaton se formulimi në Kodin Penal të Kosovës “i mbrojtur në procedura penale” jo domosdoshmërisht bën të nevojshme dhënien e një urdhri gjyqësor, por mund të përfshijë edhe masat mbrojtëse të zbatuara nga ZPS-ja gjatë hetimeve të saj. Për këto masa nuk është e nevojshme përmbushja e kriterëve të përmendura nga të

akuzuarit, ndër të cilët urdhri gjyqësor për “miratimin” e mbrojtjes, identifikimi i secilit prej personave në fjalë ose dhënia e pëlqimit nga personi për të cilin kërkohen masat mbrojtëse.

Paneli gjithashtu mban parasysh se Pika 6 e Aktakuzës, sipas nenit 392(3) të Kodit Penal të Kosovës, përfshin dy forma të rënda të veprës penale bazë. Vetëm njëra formë e rëndë është relevante në këtë çështje gjyqësore, që është rasti kur vepra penale e nenit 392(2) të Kodit Penal të Kosovës shkakton “pasoja të rënda” për personin e mbrojtur. Të akuzuarit kundërshtuan konstatimet e Trupit Gjyqësor lidhur me veprimin e fajshëm të kësaj forme të rëndë.

Paneli konstaton se të akuzuarit nuk kanë arritur të provojnë se Trupi Gjyqësor gaboi që u mbështet në dëshminë e dëshmitarit W04842 të ZPS-së. Paneli konstaton më tej se z. Gucati nuk ka arritur të provojë se pse përbën gabim përmendja nga Trupi Gjyqësor e “cenimit thelbësor” në vend të “pasojeve të rënda” në pjesën e dispozitave ligjore përkatëse të Aktgjykimit. Në fund, Trupi Gjyqësor i përmendi shprehimisht “pasoja të rënda” në konstatimet e tij lidhur me nenin 392(3) të Kodit Penal të Kosovës.

Z. Gucati gjithashtu kundërshtoi konstatimet e Trupit Gjyqësor në lidhje me dëshmitarët e rrezikuar. Për arsyet e shtjelluara në Aktgjykimin e Apelit, Paneli i Apelit konstatoi se Trupi Gjyqësor nuk gaboi që konstatoi se u shkaktoan pasoja të rënda për dëshmitarët që u zhvendosën me banim dhe që ishin objekt i planifikimit urgjent për shkak të rrezikut. Sidoqoftë, Paneli gjykon që ky konstatim vlen vetëm për dy dëshmitarët që u zhvendosën.

Lidhur me personin e identifikuar në versionin konfidencial të Aktgjykimit të Trupit Gjyqësor – i cili e kishte bërë publik bashkëpunimin e tij me prokurorët që kryenin hetime për veprat penale, të cilat pretendohet se u kryen nga anëtarë të UÇK-së – Paneli i Apelit gjykon se konstatimet në lidhje me “frikën dhe shqetësimin e këtij personi, shkaktoar nga përmendja publikisht e emrit të tij si dëshmitar” nuk bazohen në provat e disponueshme në këtë çështje gjyqësore. Trupi Gjyqësor nuk dha asnjë

shpjegim në mbështetje të konstatimit të tij dhe as nuk shpjegoi më tej nëse ishte i mendimit që ankesa lidhur me publikimin e dokumenteve të nxjerra përbënte “pasojë të rëndë”.

Për këtë arsye, Paneli i Apelit pajtohet me z. Gucati se Trupi Gjykses gaboi sa i takon këtij konstatimi konkret dhe rrjedhimisht pranon arsyen 11 të apelit të z. Gucati. Ndikimi i këtij konstatimi mbi dënimin do të diskutohet në vijim.

Në përfundim, për këtë Pikë të Aktakuzës, Paneli i Apelit pranon arsyen 11 të Apelit të z. Gucati dhe rrëzon të gjitha kundërshtimet e tjera ndaj konstatimeve të Trupit Gjykses në lidhje me Pikën 6 të Aktakuzës.

Konstatimet e Panelit të Apelit për kundërshtimet lidhur me Pikën 3 të Aktakuzës

Pika 3 përkon me veprën penale të frikësimit gjatë procedurës penale, e ndëshkueshme sipas nenit 387 të Kodit Penal të Kosovës. Paneli do të trajtojë në fillim kundërshtimet e të akuzuarve ndaj veprimit të fajshëm të kësaj vepre penale.

Paneli i Apelit paraprakisht gjykon se është e qartë që Trupi Gjykses konstatoi se të akuzuarit ishin fajtorë sipas alternativës së parë të nenit 387 të Kodit Penal të Kosovës, konkretisht se kishin përdorur kërcënime të rënda për të nxitur dikë që “të përmbahet nga dhënia e deklaratës”.

Paneli do të trajtojë së pari argumentin e z. Gucati se Trupi Gjykses gaboi që konstatoi se pjesa e fundit e nenit 387 të Kodit Penal të Kosovës, në të cilin thuhet “kur informacione të tilla ndërliohen me pengimin e procedurës penale”, cilëson vetëm alternativën e tretë të nenit 387, domethënë personin që nuk i jep “informacione të vërteta organeve policore, prokurorit apo gjykatësit”, dhe jo alternativën e parë. Për arsyet që shpjegohen në Aktgjykimin e Apelit, Paneli i Apelit është i mendimit se formulimi “pengim i procedurës penale” nuk ka lidhje me alternativën e parë të nenit 387 të Kodit Penal të Kosovës dhe, rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk gaboi që nuk

konstatoi se të akuzuarit përdorën kërcënime të rënda në lidhje me pengimin e procedurës penale.

Lidhur me përkufizimin e kërcënimit të rëndë, Paneli, në kontekstin e nenit 387 të Kodit Penal të Kosovës gjykon se synimi i ligjvënësve ishte që termi të përfshinte çfarëdo kërcënimi të rëndë për veprim të dëmshëm, dhe jo vetëm kërcënimin për përdorimin e forcës.

Gjithashtu, Paneli gjykon se, lidhur me argumentin e z. Gucati se “kërcënimi” nënkupton se një veprim i dëmshëm do të kryhet në të ardhmen, Trupi Gjykses faktikisht formuloi konstatime se persona *do të pësojnë* dëm si pasojë e veprimeve të të akuzuarve.

Lidhur me argumentin e z. Gucati se Trupi Gjykses gaboi që konstatoi se neni 387 i Kodit Penal të Kosovës nuk kërkon provë se “kërcënimi i rëndë” faktikisht e nxiti një person që të mos bënte deklaratë, Paneli gjykon se për arsyet e përfshira në Aktgjykimin e Apelit, interpretimi i Trupit Gjykses përputhet me formulimin e dispozitës dhe me qëllimin e saj.

Sa i takon argumentit të z. Haradinaj se deklaratat e tij nuk ishin kërcënime të hapura ose të nënkuptuara, Paneli gjykon se për arsyet e parashtruara në Aktgjykimin e Apelit, z. Haradinaj nuk arrin të provojë se asnjë gjykses i arsyeshëm faktesh nuk do të kishte arritur në përfundimin e Trupit Gjykses se veprimet dhe deklaratat e të akuzuarit përbënin kërcënim të rëndë.

Paneli do të trajtojë në vijim argumentet e z. Gucati lidhur me mbështetjen prej Trupit Gjykses në dëshminë e hetueses së ZPS-së (dëshmitarja W04841) në lidhje me Pikën 3 të Aktakuzës. Paneli rikujton konstatimin e vet të mëhershëm se Trupi Gjykses nuk gaboi në lidhje me mosnxjerrjen e paketave. Paneli gjithashtu gjykon se fakti që i akuzuari identifikoi publikisht vetëm gjashtë persona, nuk e zvogëlon kuadrin e nxjerrjes së informacionit, dhe as ndikon në konstatimin se është vërtetuar veprimi i fajshëm i veprës penale.

Lidhur me kundërshtimet e z. Haradinaj ndaj metodologjisë së hetueses së ZPS-së (dëshmitarja W04841), Paneli, bazuar në arsyet e shtjelluara në Aktgjykimin e Apelit, nuk e gjykon të gabuar vlerësimin që i bëri Trupi Gjykes analizës së saj të listës së dëshmitarëve.

Bazuar në sa më sipër, Paneli i Apelit konstaton se të akuzuarit nuk kanë arritur të provojnë gabim në vlerësimin e Trupit Gjykes të veprimit të fajshëm të veprës penale të Pikës 3 të Aktakuzës.

Paneli do të trajtojë në vijim kundërshtimet e z. Gucati ndaj konstatimeve të Trupit Gjykes në lidhje me synimin kriminal sipas nenit 387 të Kodit Penal të Kosovës. Së pari, Paneli gjykon se konstatimet e Trupit Gjykes se z. Gucati dhe z. Haradinaj kishin synimin e drejtpërdrejtë që të përdornin kërcënimin e rëndë për t'i bërë dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm që të mos u jepnin dëshmi Dhomave të Specializuara ose ZPS-së, janë të arsyeshme.

Lidhur me argumentin e z. Gucati se një konstatim mbi synimin kriminal ishte i nevojshëm sa i takon vërtetësisë të informacionit të dhënë nga dëshmitarët sipas nenit 387 të Kodit Penal të Kosovës, Paneli rikujton se mosdhënia e "informacionit të vërtetë" është vetëm pjesë e një prej tri alternativave në nenin 387, dhe çka është e rëndësishme, të akuzuarit nuk u shpallën fajtorë mbi bazën e saj. Rrjedhimisht, Trupi Gjykes nuk ka gabuar.

Bazuar në faktin se synimi i drejtpërdrejtë u vërtetua, Paneli i Apelit konstaton se argumentet e z. Gucati se synimi eventual nuk është i mjaftueshëm për shpallje fajësie sipas nenit 387 të Kodit Penal të Kosovës, janë hipotetike dhe nuk do të ndikonin në konstatimet.

Së fundi, Paneli i Apelit konstaton se Trupi Gjykes trajtoi konkretisht interpretimin alternativ prej z. Haradinaj të provave lidhur me synimin e drejtpërdrejtë dhe për rrjedhojë nuk ka gabuar.

Bazuar në këtë, Paneli konstaton se z. Gucati dhe z. Haradinaj nuk arritën të provonin gabim në vlerësimin e Trupit Gjykses të synimit kriminal të veprës penale të frikësimit gjatë procedurës penale.

Në përfundim, Paneli i Apelit rrëzon kundërshtimet e Mbrojtjes ndaj konstatimeve të Trupit Gjykses në lidhje me Pikën 3 dhe në vijim do të trajtojë Pikën 1 të Aktakuzës.

Konstatimet e Panelit të Apelit për kundërshtimet lidhur me Pikat 1 dhe 2 të Aktakuzës

Pika 1 e Aktakuzës ka të bëjë me veprën penale të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare përmes kërcënimit të rëndë, e ndëshkueshme sipas nenit 401(1 dhe 5) të Kodit Penal të Kosovës. Paneli do të trajtojë fillimisht kundërshtimet e të akuzuarve në lidhje me veprimin e fajshëm të veprës penale.

Lidhur me përkufizimin e kërcënimit të rëndë, Paneli gjykon se synimi i ligjvënësve ishte që termi të përfshinte çfarëdo kërcënimi të rëndë për veprim të dëmshëm, dhe jo vetëm kërcënimin për përdorimin e forcës.

Lidhur me drejtimin e kërcënimit të rëndë, Paneli, me përjashtim të mospajtimit të gjykatësit Ambos, pajtohet me konstatimin e Trupit Gjykses se në formulimin e kësaj dispozite nuk kërkohet që kërcënimi i rëndë të drejtohet konkretisht kundër personit zyrtar. Paneli i Apelit gjithashtu gjykon se interpretimi i Trupit Gjykses është në përputhje me qëllimin e dispozitës për këtë vepër penale, që nuk është të mbrojë personat zyrtarë si të tillë, por t'i mbrojë ata në kryerjen e papenguar të detyrave të tyre zyrtare. Për këtë arsye, Paneli, me përjashtim të mospajtimit të gjykatësit Ambos, nuk e gjykon të gabuar konstatimin e Trupit Gjykses se vepra penale e nenit 401(1) të Kodit Penal të Kosovës është vërtetuar në këtë çështje, ku kërcënimi i rëndë drejtohet kundër atyre që dhanë dëshmi për Dhomat e Specializuara/ZPS-në ose që me gjasë do të jepnin.

Lidhur me argumentin e z. Gucati se përdorimi i forcës ose kërcënimit të rëndë duhet të jetë i njëkohshëm me kryerjen e detyrave zyrtare, Paneli gjykon se një interpretim i tillë nuk do të ishte në përputhje me mbrojtjen që ky nen synon të ofrojë për kryerjen në siguri të detyrave zyrtare dhe nuk bazohet në tekstin e dispozitës.

Bazuar në sa më sipër, shumica e Panelit konstaton se të akuzuarit nuk kanë arritur të provojnë gabim në vlerësimin prej Trupit Gjykses të veprimit të fajshëm të veprës penale të Pikës 1 të Aktakuzës.

Paneli do të trajtojë më tej kundërshtimet e z. Gucati ndaj konstatimeve të Trupit Gjykses në lidhje me synimin kriminal të kësaj vepre penale. Paneli i Apelit gjykon se ndonëse Trupi Gjykses nuk përsëriti fjalë për fjalë standardin ligjor në konstatimin e vet për synimin e të akuzuarve, ai i paraqiti konstatimet përkatëse gjetiu në Aktgjykim, gjegjësisht se të akuzuarit synonin përdorimin e kërcënimit të rëndë kundër dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm si mjet për pengimin e zyrtarëve të Dhomave të Specializuara/ZPS-së në kryerjen e punës së tyre. Bazuar në këtë, Paneli gjykon se z. Gucati nuk ka arritur të provojë gabim në vlerësimin prej Trupit Gjykses të synimit kriminal të veprës penale të Pikës 1 të Aktakuzës.

Në përfundim, shumica e Trupit Gjykses rrëzon kundërshtimet e Mbrojtjes ndaj konstatimeve të Trupit Gjykses në lidhje me Pikën 1 të Aktakuzës.

Paneli do të trajtojë tani arsyet e apelit të z. Gucati dhe të z. Haradinaj sa i përket raportit të bashkimit të veprave midis Pikave 1 dhe 2 të Aktakuzës (konkretisht veprat penale të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, përmes forcës ose kërcënimit të rëndë dhe pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, përmes veprimit të përbashkët të një grupi). Trupi Gjykses zbatoi standardin e fajësisë së shumëfishtë, i cili është zbatuar prej tribunalëve penalë ndërkombëtarë *ad hoc* që mundëson verdikte të fajësisë penale në bazë të dispozitave ligjore të ndryshme në qoftë se secila dispozitë ligjore në fjalë përmban një element materialisht të

dallueshëm që nuk e përmban tjetra. Bazuar në këtë standard, Trupi Gjykes i shpalli fajtorë të akuzuarit si për Pikën 1, ashtu edhe për Pikën 2 të Aktakuzës.

Sidoqoftë, për arsyet e shpjeguara në Aktgjykimin e Apelit, Paneli i Apelit gjykon se standardi i fajësisë së shumëfishtë i së drejtës penale ndërkombëtare zbatuar nga Trupi Gjykes, nuk është i përshtatshëm në rrethanat konkrete të kësaj çështjeje. Paneli vendosi të mbështetej në konceptin e së drejtës civile të bashkimit të veprave. Në lidhje me këtë, Paneli ndër të tjera gjykoi se ndryshimi në dënimet minimale midis dy dispozitave mund të shpjegohet prej faktit se paragrafi i parë i nenit 401 të Kodit Penal të Kosovës kërkon veprime individuale konkrete të pengimit, kurse në kontekstin e paragrafit të dytë, përgjithësisht nuk do të ishte e mundshme të vërtetoheshin veprime individuale konkrete të pengimit nga të akuzuarit. Mbi këtë bazë, Paneli gjykon se raporti midis këtyre dy dispozitave ngërthehet më së miri prej rregullës së subsidiaritetit dhe se, në këtë çështje, ku veprimet individuale të të akuzuarve janë specifikuar dhe të akuzuarit janë shpallur fajtorë në bazë të nenit 401(1), një verdikt i mëtejshëm fajësie në bazë të nenit 401(2), nuk është as i përligjur, as i nevojshëm.

Si rrjedhojë, Paneli miraton arsyen 16 të apelit të z. Gucati dhe pjesërisht arsyen 3 të apelit të z. Haradinaj, vendos se të akuzuarit mund të shpallen fajtorë vetëm për Pikën 1 të Aktakuzës dhe i shpall të pafajshëm për Pikën 2 të Aktakuzës. Ndikimi i këtij konstatimi, nëse do të ketë, mbi dënimin e të akuzuarve, do të trajtohet më poshtë.

Bazuar në këtë konstatim, Paneli gjykon se është e panevojshme të trajtohen argumentet e z. Gucati lidhur me Pikën 2 të Aktakuzës dhe pretendimet e tij për gabime të Trupit Gjykes në lidhje me veprimin e fajshëm dhe synimin kriminal sipas nenit 401(2) të Kodit Penal të Kosovës.

Konstatimet e Panelit të Apelit për kundërshtimet lidhur me argumentet mbrojtëse dhe arsyet për përjashtimin e përgjegjësisë

Paneli tani do të trajtojë tani kundërshtimet e z. Gucati dhe z. Haradinaj lidhur me argumentet mbrojtëse dhe arsyet për përjashtimin e përgjegjësisë për sjelljen e tyre. Në

grykim, të akuzuarit paraqitën disa argumente mbrojtëse dhe arsye për përjashtimin e përgjegjësisë për sjelljen e tyre. Sidoqoftë, Trupi Gjykses konstatoi se përgjegjësia penale të akuzuarve nuk mund të përjashtohet mbi bazën e argumenteve mbrojtëse apo arsyeve për përjashtimin e përgjegjësisë të paraqitura prej tyre.

Në apelet e tyre, të akuzuarit ngritën kundërshtime ndaj konstatimeve të Trupit Gjykses, që nuk pranuan argumentet e paraqitura prej tyre në lidhje me: (i) interesin publik; (ii) sinjalizimin; (iii) shtytjen për kryerje të veprës penale; (iv) nevojën ekstreme; dhe (v) vepra të rëndësisë së vogël.

Për arsyet e shtjelluara në Aktgjykimin e Apelit, Paneli rrëzon të gjitha arsyet e apeleve të të akuzuarve në lidhje me këto aspekte. Paneli nuk do të japë përmbledhje të detajuar të secilit prej konstatimeve të veta. Sidoqoftë, Paneli do të trajtojë aspekte konkrete me interes në këtë përmbledhje.

Së pari, lidhur me mbrojtjen e interesit publik, Paneli pranon se disa nga argumentet e Gucatit kanë të bëjnë me standardin dhe detyrimin e vërtetimit për arsye që përjashtojnë përgjegjësinë penale, standard ky që kërkon vëmendje të veçantë.

Duke iu referuar një numri burimesh, Paneli sqaron se ka ndryshim midis detyrimit të ZPS-së për vërtetimin e fajësisë së të akuzuarit jashtë dyshimit të arsyeshëm (detyrimi për të bindur) dhe përgjegjësisë së Mbrojtjes për paraqitjen e provave në mbështetje të arsyeve që përjashtojnë përgjegjësi penale (detyrimi i paraqitjes së provave ose detyrimi i provave).

Së dyti, lidhur me pretendimin e Mbrojtjes të shtytjes për kryerje të veprës penale nga ZPS-ja, Paneli është i vetëdijshëm se palët kanë paraqitur parashtrime të gjata mbi këtë temë që është debatuar gjerësisht si në fazën e grykimit, ashtu edhe atë të apelit të këtij procesi.

Paneli vëren se Trupi Gjykses me të drejtë konstatoi se “përveç nëse pretendimet e të akuzuarve janë tërësisht të pagjasa, i takon prokurorisë të provojë se nuk pasur shtytje

për kryerje të veprës penale”, si dhe identifikoi saktësisht detyrimin e gjykatës që “të shqyrtojë faktet e çështjes dhe të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të zbuluar nëse ka pasur shtytje për kryerjen e veprës penale”. Në pajtim me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për Të Drejtat e Njeriut, Trupi Gjykues nuk gaboi që iu referua kriterit të provave *prima facie*.

Paneli i Apelit në vijim konstaton se Mbrojtja keqintepretton standardin e zbatueshëm nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për Të Drejtat e Njeriut kur argumenton se standardi “jo tërësisht i pagjasë” është kaq i ulët sa që përjashton çdo kriter për paraqitje provash prej Mbrojtjes.

Për këto arsye, të detajuara e shtjelluara në Aktgjykimin e Apelit, Paneli i Apelit konstaton se z. Gucati dhe z. Haradinaj nuk kanë arritur të provojnë se Trupi Gjykues gaboi që konstatoi se pretendimi i shtytjes për kryerje të veprës penale i ngritur prej tyre, ishte tërësisht i pagjasë dhe i pabazuar.

Konstatimet e Panelit të Apelit për kundërshtimet lidhur me masën e dënimit

Paneli tani do të trajtojë kundërshtimet e z. Gucati dhe z. Haradinaj në lidhje me dënimin.

Së pari Paneli do të trajtojë kundërshtimet e z. Gucati ndaj vlerësimit prej Trupit Gjykues të peshës së krimit. Sikurse është shtjelluar më tej në Aktgjykimin e Apelit, Paneli gjykon se Trupi Gjykues nuk gaboi në konstatimet e veta lidhur me peshën dhe shkallën e veprave penale të kryera prej të akuzuarve, të përfshira në Aktakuzë.

Paneli i referohet argumentit të z. Gucati se Trupi Gjykues gaboi që nuk e pasqyroi si duhej në përcaktimin e dënimit rolin konkret të Gucatit, krahasuar me atë të z. Haradinaj sipas Pikës 3 të Aktakuzës. Paneli gjykon se Trupi Gjykues vlerësoi me kujdes provat dhe të gjithë faktorët përkatës për përcaktimin e dënimit, si edhe rolin e z. Gucati në veprat penale, në krahasim me rolin e z. Haradinaj. Rrjedhimisht, Paneli

konstaton se z. Gucati nuk ka arritur të provojë gabim në përcaktimin e dënimit të tij nga Trupi Gjykses në lidhje me Pikën 3 të Aktakuzës.

Sikurse arsyetohet më tej në Aktgjykimin e Apelit, Paneli gjithashtu rrëzoi kundërshtimet e z. Haradinaj ndaj konstatimeve të Trupit Gjykses në përcaktimin e dënimit, në lidhje me atmosferën e frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë dhe ushtrimin prej z. Haradinaj të së drejtës së lirisë së shprehjes.

Paneli gjykon se sikurse u diskutua gjithashtu gjatë seancës së apelit, përputhshmëria në dënim është e rëndësishme, por duhet mundësuar ushtrimi i kompetencës diskrecionale të Trupit Gjykses lidhur me faktet e çështjes konkrete. Sikurse shtjellohet më tej në Aktgjykimin e Apelit, Paneli i mori parasysh çështjet gjyqësore përkatëse në Kosovë dhe çështje përkatëse të gjykatave dhe tribunalëve ndërkombëtarë, të paraqitura nga palët.

Paneli është i vetëdijshëm për ndryshimet midis dënimeve të dhëna nga gjykata dhe tribunalë penalë ndërkombëtarë dhe dënimeve në këtë çështje. Sidoqoftë, Paneli i Apelit nuk mund të shpërfillë faktet konkrete të kësaj çështjeje, të marra në kontekstin e kornizës ligjore në fuqi të Kosovës dhe shkallëzimin e dënimeve në Kodin Penal të Kosovës. Duke marrë parasysh peshën e veprave penale të të akuzuarve, Paneli i Apelit konstaton se Trupi Gjykses nuk gaboi në përcaktimin e dënimeve të të akuzuarve mbi bazën e fajësisë së shpallur për pikat përkatëse të Aktakuzës.

Paneli gjithashtu konstatoi se gabimi i Trupit Gjykses i identifikuar në Pikën 6 të Aktakuzës në lidhje me formën e rëndë të veprës penale, nuk pati ndikim mbi dënimin.

Sidoqoftë, Paneli i Apelit rikujton konstatimet e veta të mëhershme në lidhje me Pikat 1 dhe 2 të Aktakuzës, në të cilat prapësoi verdiktin e fajësisë së z. Gucati dhe z. Haradinaj për Pikën 2 të Aktakuzës. Si pasojë, Paneli gjykon se dënimet e njësuara të dhëna nga Trupi Gjykses, duhet të ulen. Për arsyet e shtjelluara në Aktgjykimin e Apelit, Paneli i Apelit, me përjashtim të mospajtit të gjykatësit Ambos, vendos që

dënimi për z. Gucati dhe z. Haradinaj të ulet me tre muaj, në një dënim të njësuar me katër vjet e tre muaj burgim.

Gjykatësi Ambos pajtohet me arsyetimin dhe konstatimet e Panelit të Apelit në lidhje me Pikat 3, 5 dhe 6 të Aktakuzës. Gjithashtu ai pajtohet me arsyetimin e Panelit të Apelit lidhur me raportin e bashkimit të veprave midis paragrafit 1 dhe paragrafit 2 të Kodit Penal të Kosovës (Pikat 1 dhe 2). Gjykatësi Ambos gjithsesi nuk pajtohet me shumicën në lidhje me interpretimin e veprimit të fajshëm sipas nenit 401(1) të Kodit Penal të Kosovës. Rrjedhimisht, mbi këtë bazë, ai do t'i kishte shpallur të pafajshëm të akuzuarit në lidhje me Pikën 1 të Aktakuzës dhe do ta kishte ulur dënimin e dhënë kundër tyre në katër vjet.

Vendim

Paneli i Gjykatës së Apelit, në bazë të nenit 46 të Ligjit dhe rregullave 182 dhe 183 të Rregullores:

PRANON arsyet 11, 16 dhe pjesën përkatëse të arsyes 20 të apelit të z. Gucati dhe pjesën përkatëse të arsyes 3 dhe pjesën përkatëse të arsyes 24 të apelit të z. Haradinaj;

RRËZON apelet e z. Gucati dhe Haradinaj në të gjitha pikat e tjera;

PRAPËSON verdiktin e fajësisë së z. Gucati dhe të z. Haradinaj për pengimin e personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare përmes pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi sipas Pikës 2 të Aktakuzës;

LË NË FUQI verdiktin e fajësisë së z. Gucati dhe z. Haradinaj për frikësim gjatë procedurës penale sipas Pikës 3 të Aktakuzës, shkelje të fshehtësisë së procedurës përmes zbulimit të paautorizuar të informacionit të fshehtë të nxjerrë në procedurë zyrtare sipas Pikës 5 të Aktakuzës, dhe shkelje të fshehtësisë së procedurës përmes zbulimit të paautorizuar të identiteteve dhe të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur sipas Pikës 6 të Aktakuzës

dhe **GJITHASHTU LË NË FUQI**, me përjashtim të mospajtimit të gjykatësit Ambos, verdiktin e fajësisë së z. Gucati dhe z. Haradinaj për pengimin e personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare përmes kërcënimit të rëndë sipas Pikës 1 të Aktakuzës;

ANULON dënimin e njësuar prej katër vjet e gjysmë burgim për z. Gucati dhe z. Haradinaj dhe **CAKTON**, me përjashtim të mospajtimit të gjykatësit Ambos, një dënim të njësuar me katër vjet e tre muaj burgim për z. Gucati, duke llogaritur edhe kohën e paraburgimit, dhe një dënim të njësuar me katër vjet e tre muaj për z. Haradinaj duke llogaritur kohën e paraburgimit;

LË NË FUQI dënimin shtesë për z. Gucati dhe z. Haradinaj me një gjobë prej njëqind eurosh (100 EUR);

VENDOS që ky Aktgjykim të zbatohet me efekt të menjëhershëm në bazë të rregullës 185(1) të Rregullores; dhe

URDHËRON që, në pajtim me nenin 50(1) të Ligjit dhe rregullën 166(3) të Rregullores, z. Gucati dhe z. Haradinaj të mbeten në paraburgim të Dhomave të Specializuara deri në finalizimin e masave për transferimin e tyre në shtetin ku do të vuajnë dënimin.